



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.18/2018  
Prishtinë, më 6.3.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Molliqaj, Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

**Të ftuar:** z. Shuqeri Musliu, drejtor i Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) - Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

**Pjesëmarrës të tjerë:** Adem Ahmetaj, Shahe Kukaj-Krasniqi, Fidaim Spahiu, Arbërore Bernica, Filloreta Gashi– MZHE (NJPMNP); Ardit Kika-BIRN; Agnesa Haxhiu-KDI; Albulena Mavraj,“Epoka e re”; Dardan Abazi-INDEP; Dren Ajeti-KPK; Hysni Komoni, Marcelë Ponosheci, Sherafedin Mumxhiu-MZHE.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.2.2018;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016;**
4. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion;**
5. **Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve;**
6. **Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.2.2018.**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 27.2.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016**

**Kryetarja**, theksoi se mbledhjen e kaluar e ndërpreme shqyrtimin e kësaj pike, në mënyrë që në këtë mbledhje të kemi edhe përfaqësuesit e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Kryetarja ia dha fjalën përfaqësuesit të ministrisë, që fillimisht të prezantojë raportin e performancës dhe mandej të përgjigjen në pyetjet e deputetëve.

**Shuqeri Musliu, NJPMNP**, theksoi se sapo ka filluar punën si drejtor i njesisë. Ai foli për strukturën dhe përgjegjësitë e njesisë, ndërsa theksoi se raportin do ta prezantojë z. Adem Ahmetaj nga NJPMNP.

**Adem Ahmetaj, NJPMNP**, u shpreh se jemi këtu për të prezantuar Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016. Ai theksoi se raporti është i fokusuar në tri çështje kryesore: në performancën operative, performancën financiare dhe qeverisjen korporatave. Ky raport paraqitet nga perspektiva e aksionarit. Tri elemente që janë trajtuar në raport për ndërmarrjet publike, janë pagat, të hyrat dhe kthimi në pasuri. Ai potencoi se performanca e ndërmarrjeve publike nuk është e kënaqshme. Nga 16 ndërmarrje publike, 6 ndërmarrje janë me fitim, ndërsa 10 operojnë me humbje, si dhe aeroporti i Gjakovës që nuk është funksional. Në raport janë përfshirë edhe opinionet e auditorit të jashtëm, ku janë dhënë cilësimet për ndërmarrjet publike. Raporti paraqet edhe performancën sipas sektorëve, ku te sektori i energjisë ka pasur rritje të lehtë në gjenerim dhe rritje të nxjerrjes së linjtit rreth 7%. Te sektori i telekomunikacionit kemi paraqitur humbje 31 milionë euro, nga të dhënat që kemi marrë nga menaxhmenti, sepse për shkak të mungesës së bordit nuk është miratuar raporti i auditimit dhe nuk i kemi pasur të dhënat nga raporti i auditimit. Numri i konsumatorëve ka pësuar rënie në telekom, internet, si dhe operatorit mobil Vala. Te sektori i ujit janë 7 kompani rajonale, prej të cilave shërbime marrin 1 milion e 500 mijë banorë apo rreth 91%, pjesa tjetër janë ujësjellës ruralë që po synojmë të futen brenda ujësjellësve rajonalë. Ndërsa, sistemi i kanalizimit ka mbulesë rreth 65% në 2015 dhe rreth 70% në 2016. Faturimi i ujit është rreth 44%, ndërsa inkasimi 86% e ujit të faturuar. Kurse, uji i pafaturuar është rreth 57%, që do të thotë ka pasur zhvillim negativ nga viti 2015 në vitin 2016 për 1%. Mbulimi me ujëmatës për konsumatorët shtëpiakë ka mbetur në 92%, dhe në këtë aspekt, prin Prishtina me 97%, ndërsa Mitrovica mbetet vetëm me 64%. Është problematik te ujësjellësi i Mitrovicës, diku 40% e ujit që prodhohet nga ujësjellësi i Mitrovicës, distribuohet në veri dhe për këtë ujë nuk paguhen faturat nga veriu. Shumë herë, Qeveria e Kosovës e ka subvencionuar ujësjellësin e Mitrovicës.

**Kryetarja**, tha se disa pyetje i kam bërë javën e kaluar dhe tani dua të pyes lidhur me ujësjellësin e Mitrovicës. Faturimi, a bëhet vetëm për pjesën e veriut apo për tërë rajonin?

**Dardan Sejdiu**, theksoi se raporti që po shqyrtojmë nuk do të ketë asnjë efekt as për 2017 e madje, as për 2018. Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve publike kanë opinion negativ të auditorit. Çka ndërmerrni ndaj këtyre ndërmarrjeve publike, kur vjen një raport i tillë i auditorit? Te performanca financiare, 29 milionë janë humbje në telekom, sikur të performonte sipas planit të biznesit për 2016, do të ishte pozitiv. Nëse i bëjmë krahasim proporcional me operatorët privatë, shohim se operatorët privatë kanë më pak treg, ndërsa fitimin e kanë më të madh. Pse ka qenë kjo diskrepancë në mes planifikimit dhe realizimit, kush kanë qenë shkaktarët kryesorë? Në raport shihet se KEK-u ka pasur fitim në gjenerim për 11 milionë dhe ne si institucione e anashkalojmë KEK-un. A ju ka konsultuar dikush, lidhur me kapacitetet financiare të KEK-ut për gjenerator të ri? Si është e mundur që Telekom i Kosovës me 2274 punëtorë, me 76 milionë euro të hyra, me rreth 55% të tregut, ndërsa Ipko me 430 punëtorë, me 35% të tregut, ka po ato të hyra? Ndërmarrjet publike, nëse i analizoni mirë, secila ka treg të garantuar. Çka po ndodh me NP-të, që janë në nivel të ulët të performancës? Sa herë ju si njësi i raportoni ministrit lidhur me performancën e NP-ve? A është e mundur që këtij komisioni t'i dërgohet raporti i tillë i fundit?

**Mimoza Kusari-Lila**, tha se ajo që është brengosëse, shohim se brenda dy apo tre viteve nuk kemi do të kemi asnjë ndërmarrje publike profitabile. Do të duhej një strategji për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, për të dalë nga kjo situatë. Edhe ne si shoqëri do të dalim të paaftë për të menaxhuar sektorin publik. Ka rritje të numrit të punëtorëve, nga viti në vit, por ka edhe rënie të performancës. A ka nevojë nga aspekti profesional për rritje të numrit të punëtorëve, si argumentohet rritja e numrit të punëtorëve? Pas marrjes së opinionit të auditorit, a ka rekomandime nga ministri për ndërmarrjet publike? A ka kërkesa për investime kapitale që vijnë në njësi dhe cilat janë procedurat e shqyrtimit të kërkesave të tilla?

**Bilall Sherifi**, tha se kur shtrohet pyetja, pse ndërmarrjet publike nuk janë me fitim të njëjtë me ndërmarrjet private, është se ndërmarrjet publike janë “tonat”, ndërsa ndërmarrja private është “e imja”. Ne e dimë që NP-të janë të mbipopulluara dhe këtë e kanë bërë të gjitha qeveritë. Fakti se këto ndërmarrje e kanë tregun e garantuar ka ndikuar që të bie performanca e tyre.

**Kryetarja**, theksoi se vlera e telekomit po shkon duke u degraduar. Ju si Njësi për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, duhet ta keni obligim që t'i krahasoni ndërmarrjet publike, duke iu ofruar vendimmarrësve të dhëna, ashtu si është situata.

**Hykmete Bajrami**, pyeti: Si do t'iu qaseni ndërmarrjeve publike në të ardhmen? Pse me kaq vonesë raporti i performancës? Ndërmarrjet publike ekzistojnë dhe subvencionohen vetëm kur kostoja sociale është më e shtrenjtë, nëse ofrohet nga sektori privat. Telekom i ka shkuar duke rënë, qoftë nga papërgjegjësia e bordit apo menaxhmentit. Sa i përket numrit të punëtorëve, posta kur ka pasur subvencionim, ka pasur rritje të punëtorëve. Si do të jetë qasja e ministrisë ndaj ndërmarrjeve publike?

**Adem Ahmetaj, NJPMNP**, duke u përgjigjur në pyetje, tha se për 40% të ujit, që distribuohet në veri, nuk paguhet nga komuniteti serb dhe për këtë është e obliguar Qeveria, herë pas here, ta subvencionojë Mitrovicën.

**Shahe Kukaj-Krasniqi, NJPMNP**, tha se ky raport bazohet në raportet e ndërmarrjeve publike dhe në ligjin për ndërmarrjet publike. Raporti i performancës bëhet ndoshta me vonesë, sa i përket periudhës kohore, por bëhet në bazë të ligjit, sepse ky raport bëhet pas qershorit të vitit vijues, pasi që ndërmarrjet publike janë audituar. Në momentin që përgatitet ky raport, i dërgohet ministrit dhe ai mandej vendos kur e thërret Këshillin Ndërmarrësor për ndërmarrjet publike. Gjatë hartimit të raportit, bazohemi në të dhënat e raportit të auditimit. Në rastin e Telekomit të Kosovës nuk ka pasur bord, që është organ i miratimit të të gjitha dokumenteve publike. Raporti i auditorit për telekomin nuk është miratuar nga bordi, në mungesë të bordit dhe ne nuk i kemi pasur të dhënat e audituara, por jemi shërbyer me të dhëna nga menaxhmenti i ndërmarrjes. Diskrepanca mes planifikimit dhe realizimit vjen si pasojë, se ndërmarrjet bëjnë plan biznesi që nuk mund të arrihet. Rënia në telekom fillon nga viti 2012. Në kohën e procesit të privatizimit nuk ka pasur të drejtë të bëjë investime kapitale. Po ashtu, kanë ndikuar edhe konkurrenca, tregu i zi, interneti dhe TV-ja. Edhe marrëveshja me Z Mobile ka ndikuar në rënien e performancës. Ne i raportojmë ministrit çdo tre muaj dhe gjashtë muaj. Ne monitorojmë bordet e ndërmarrjeve publike, njësia nuk ka fuqi ekzekutive.

**Adem Ahmetaj, NJPMNP**, sqaroi se për investimet kapitale, NP-të i dërgojnë kërkesat në ministri sipas procedurave të rregullta dhe ato projekte që janë prioritet, financohen. Prioriteti vendoset sipas përpunimit të kërkesave në sistem dhe për këtë vendos Qeveria. Ne vetëm bëjmë një lloj procedimi të kërkesave të tyre.

**Mimoza Kusari-Lila**, potencoi se arsyeja që po e bëj pyetjen për kërkesat për investime kapitale është se ministri Lluka është tërhequr komplet nga pyetja ime për investime kapitale në KRU “Radoniqi”, duke thënë se ai ka qenë tërësisht vendim i ndërmarrjes dhe i bordit, po pyes për përgjegjësi institucionale dhe linjë të kompetencave, në raport të ministrisë me ndërmarrjet publike.

**Fidaim Spahiu, NJPMNP**, sqaroi se projektet kapitale janë politikë zhvillimore e NP-ve, të cilat aprovohen nga Bordi i Drejtorëve, kur ato financojnë prej buxhetit vetjak. Për kërkesat për financim nga Qeveria, ne si njësi, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, i dërgojmë kufijtë buxhetorë të ndërmarrjeve publike. Ato projekte kapitale vijnë në ministri, së bashku me Departamentin e Buxhetit, i delegojmë në të gjitha fazat e përpilimit të kornizave afatmesme dhe përfundon në hartimin ose me miratimin e ligjit të buxhetit. Ne i monitorojmë deri në përfundim, projektet që financohen nga Qeveria, ndërsa ndërmarrjet publike me mjete të veta mund të bëjnë investime kapitale.

*Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “kundër” dhe asnjë “abstenim”, nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta miratojë Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016, ndërsa Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të*

*njoftojë komisionin me raportet tremujore që hartohen nga Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.*

*2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit.*

*3. Kërkohej prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që para shqyrtimit në seancë plenare të raportit të performancës për ndërmarrjet publike, të dërgojnë si aneks në Kuvend, raportet e auditimit për secilën NP, si dhe një raport mbi punësimin për secilën NP, për periudhën që mbulojnë raportet e performancës së NP-ve.*

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion**

**Kryetarja**, theksoi se grupi i punës ka amendamentar këtë projektligj dhe ka paraqitur këtë raport me amendamente. Raportin me amendamente do ta paraqesë deputeti Dardan Sejdiu, si kryesues i grupit punues.

**Dardan Sejdiu**, sqaroi se grupi punues është takuar dhe ka shqyrtuar projektligjin, duke miratuar 14 amendamente. Ai propozoi që, nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, t'i votojmë në bllok.

*Propozimi i z.Sejdiu u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, komisioni nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion.*

*2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

*Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.*

#### **5. Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve**

**Kryetarja**, theksoi se në procedurë kemi disa projektligje, të cilat pritet të miratohen në parim në seancë plenare dhe kërkoi që të formohen grupet punuese për shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

*Pas konsultimeve, komisioni nxori këtë:*

#### *Vendim*

*1. Formohen grupet e punës për shqyrtimin e projektligjeve, si vijon:*

- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për miniera dhe minerale ka këtë përbërje: Sala Berisha- Shala, kryesuese, Adem Hoxha, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila dhe Duda Balje, anëtarë.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit ka këtë përbërje: Mimoza Kusari - Lila kryesuese, Sala Berisha- Shala, Dardan Sejdiu dhe Bilall Sherifi, anëtarë.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për shërbimet postare ka këtë përbërje: Sala Berisha- Shala, kryesuese, Dardan Sejdiu dhe Bilall Sherifi, anëtarë.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për masat mbrojtëse në importe ka këtë përbërje: Dardan Sejdiu, kryesues, Hykmete Bajrami dhe Memli Krasniqi, anëtarë.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për produkte të ndërtimit ka këtë përbërje: Hykmete Bajrami, kryesuese, Sala Berisha- Shala dhe Duda Balje, anëtare.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për metrologji ka këtë përbërje: Mimoza Kusari- Lila, kryesuese, Sala Berisha- Shala dhe Hykmete Bajrami, anëtare.*
- *Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konfirmimit ka këtë përbërje: Hykmete Bajrami, kryesuese, Dardan Sejdiu, Dardan Molliqaj dhe Duda Balje, anëtarë.*

## **6. Të ndryshme**

### **Çështjet vijuese**

**Kryetarja** njoftoi anëtarët e komisionit se organizata “PIPS” ka kërkuar takim me komisionin dhe propozoi që ky takim të mbahet në mbledhjen e radhës të komisionit.

*Komisioni e përkrahu propozimin e kryetares.*

**Mbledhja përfundoi në orën 13:00.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e komisionit.**

**Kryetarja e komisionit**

**Sala BERISHA SHALA**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;**  
**Komisioni për Buxhet dhe Financa;**  
**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;**  
**Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;**  
**Komisioni për Integritet Evropian;**

**Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;**

**Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion;**

**Datë: 6.3.2018, Prishtinë;**

---

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 6.3.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

### **Amendamenti 1**

Neni 1, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

"Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me: 2.1. Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/68/BE, e datës 15 maj 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare që kanë të bëjnë me vënien në dispozicion të tregut të pajisjeve nën presion;

2.2. Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/29/BE, e datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare që kanë të lidhje me vënien në dispozicion të tregut të enëve të thjeshta nën presion;

2.3. Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2010/35 /BE, e datës 16 qershor 2010 mbi pajisjet e transportueshme nën presion dhe shfuqizimin e Direktivave të Këshillit 76/767/EEC, 84/525/EEC, 84/526/EEC, 84/527/EEC dhe 1999/36/EC;

2.4. Direktivën e Komisionit 2008/47/EC, e datës 8 prill 2008 për ndryshimin, me qëllim të përshtatjes sipas progresit teknik, të Direktivës së Këshillit 75/324/EEC për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me dispenzuesit aerosolë."

### **Amendamenti 2**

Neni 3, pas nënparagrafit 1.1., shtohen tre (3) nënparagraf të rinjë, si vijon:  
1.2. Ministria – ministria përgjegjëse për pajisjet nën presion;  
1.3. Komprimin – ngjeshje e ajrit, avullit ose gazrave;  
1.4. GLN – gazi i lëngëzuar i naftës;

### **Amendamenti 3**

Neni 3, në nënparagrafin 1.10., fjala "suspension" zëvendësohet me "përzierje heterogjene e grimcave të ngurta të imëta dhe fluideve".

### **Amendamenti 4**

Neni 4, nënparagrafi 2.1., fjala "rregullave" zëvendësohet me "të këtij Ligji".

### **Amendamenti 5**

Kapitullit III dhe Nenit 5, iu ndryshohen titujt, si vijon:  
"KAPITULLI III – VËNIA NË TREG  
Neni 5 Kushtët për vënie në treg".

### **Amendamenti 6**

Neni 5, paragrafit 7, pjesës së dytë të tij, i shtohet teksti si vijon: "në këro raste vendosët në paketim".

### **Amendamenti 7**

Neni 11, paragrafi 3, pas fjalës "regjistruar" shtohet teksti " në Kosovë në bazë të legjislacionit në fuqi,".

### **Amendamenti 8**

Neni 12, nënparagrafi 6.1., fjalia "dhe me përvojë të kënaqshme" zëvendësohet me "profesionale".

### **Amendamenti 9**

Neni 13, referenca "pika një" zëvendësohet me "paragrafin 1."

### **Amendamenti 10**

Në titullin dhe në tëë nenin 14, fjala "shqyrtimi/shqyrtimin" zëvendësohet me "ekzaminim/ekzaminimin".

### **Amendamenti 11**

Neni 19, paragrafit 2, i fshihet teksti: "Kjo nuk e përjashton mundësinë e këshill dhënies."



### **Amendamenti 12**

Neni 20, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

“Për shkeljen e nenit 5, nenit 10, paragrafëve 2.,3. dhe 4. të nenit 14, si dhe paragrafët 1.,2. dhe 3. të nenit 15, ndëshkohet me gjobë si në vijim:”.

### **Amendamenti 13**

Neni 23, riformulohet si vijon:

“Inspektorati përgjegjës për pajisjet nën presion publikon masat e ndërmarra ndaj operatorëve ekonomik, me qëllim të informimit të publikut.”

### **Amendamenti 14**

Neni 24, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

“Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas paragrafi 1. të këtij neni, vlejné aktet nënligjore në fuqi, derisa nuk janë në kundërshtim me këtë ligj”.

**Kryetarja e Komisionit**

**Sala BERISHA SHALA**